# RAPORT TEKNIK

# PËR AKTIVITETIN

# KARRIERE SIPERFAQSORE



Klasifikimi i subjekti sipas ligjit Nr. 10 440 datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I Projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të Vlerësimit Të Ndikimit Në Mjedis.

Shtojca:I Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Adresa: **Vendburimi Vodice-Bogdani Roshnik,Berat**.

## BERAT 2021

GREEN-STUDIO
Adresa:Lagja 7 Rr Hajdar Demiri Durres
Cel +355 69 37 67 595
E-mail:green-studio@hotmail.com
Green-Studio

## *Raporti Teknik i projektit:*

***a) përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar;***

***b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;***

***c) informacionin për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;***

***ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit;***

***d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;***

***dh) të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja; e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;***

***ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit;***

***f) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji); g) informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit; gj) informacion për alternativat e marra në***

***konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;***

***h) të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe për mënyrën e sigurimit të tyre;***

***i) të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;***

***j) informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit.***

***k) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.***

**a) përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar;**

Qellimi i projektit te propozuar eshte shfrytezimi i masivit ranor me kariere me punime siperfaqesore per furnizimin,te tregut te indutrise se perpunimit te ketij masivi si gure dekorativ , ne gjendje qe te perkrah zhvillimin ekonomik te shoqerise dhe te permiresoje gjendjen ekzistuese te lendeve te para si dhe Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis per aktivitetin hapje, pergatitje dhe shfrytezim**.** Kjo zone eshte e preferuar per shfrytezimin e mineralit ranor masiv me kariere me punime siperfaqesore sepse ka te ngritur infrastrukturen rrugore ka lehtesira ne transport me kosto te ulet te prodhimit dhe ndodhet jo shume larg nga fabrikat e perpunimit te tij.

**Kordinatat Gaus-Kruger.**

| Nr | Y | X |
|---|---|---|
| 1 | 4420380.00 | 4507172.50 |
| 2 | 4420510.00 | 4507369.00 |
| 3 | 4420510.13 | 4507770.00 |
| 4 | 4420028.00 | 4507702.00 |
| 5 | 4420002.00 | 4507520.00 |
| 6 | 4420262.35 | 4507593.15 |
| 7 | 4420280.00 | 4507295.00 |
| 8 | 4420253.00 | 4507178.00 |

**Nga pikpamja topografike**, aktiviteti shtrihet në një terren kodronoro malor.

**Nga pikpamja kadastrale** aktiviteti ndodhet venburimin Vodice-Bogdan,Roshnik,Berat.

**b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë**

Me kërkesë të subjektit B&B STONE shpk po përpilohet studimi i gjendjes së zonës në të cilën ndodhet leja minerare qe aktiviteti ka marre per shfrytezim te mineralit ranor masiv,me vendodhje në, Vendburimi Vodice-Bogdan,Roshnik,Berat. Leja e shfrytezimit me nr 1379/1 ka nje siperfaqe prej 0.017 km2.

*Ortofoto e vendodhjes.*




Sipërfaqja e marë në shfrytëzim është 17 ha objekti që ushtrohet shfrytëzimi i gurit ndodhet ne fshatin Vodicë, Berat.

*Kordinatat Gaus-Kruger.*

| Nr | Y | X |
|---|---|---|
| 1 | 44 20 380.00 | 45 07 172.50 |
| 2 | 44 20 510.00 | 45 07 369.00 |
| 3 | 44 20 510.13 | 45 07 770.00 |
| 4 | 44 20 028.00 | 45 07 702.00 |
| 5 | 44 20 002.00 | 45 07 520.00 |
| 6 | 44 20 262.35 | 45 07 593.15 |
| 7 | 44 20 280.00 | 45 07 295.00 |
| 8 | 44 20 253.00 | 45 07 178.00 |

***Foto***








| Nr | X | Y |
|---|---|---|
| 1 | 4507172 | 4420380 |
| 2 | 4507369 | 4420510 |
| 3 | 4507770 | 4420510 |
| 4 | 4507402 | 4420028 |
| 5 | 4507520 | 4420002 |
| 6 | 4507593 | 4420262 |
| 7 | 4507295 | 4420280 |
| 8 | 4507178 | 4420253 |
| S=0.01669 km2 | | |

GREEN-STUDIO
Adresa:Lagja 7 Rr Hajdar Demiri Durres
Cel +355 69 37 67 595
E-mail:green-studio@hotmail.com
Green-Studio




Adresa:Lagja 7 Rr Hajdar Demiri Durres
Cel +355 69 37 67 595
E-mail:green-studio@hotmail.com
Green-Studio
GREEN-STUDIO

**c) informacionin për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti**

Me kërkesë të subjektit B&B STONE shpk po përpilohet studimi i gjendjes së zonës në të cilën ndodhet leja minerare qe aktiviteti ka marre per shfrytezim te mineralit ranor masiv,me vendodhje në, Vendburimi Vodice-Bogdan,Roshnik,Berat. Leja e shfrytezimit me nr 1379/1 ka nje siperfaqe prej 0.017 km2.

Zona ku ndodhet vendburimi është rreth 500m ne vije ajerore larg nga banesat e Fshatit Bogdan i Poshtem dhe rreth 800 m ne vije ajrore nga Fshati Karkanjoz.



**ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit.**




MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE DHE INDUSTRISË
OBJEKTI "Vodice Bogdani", Roshnik, Qarku Berat

| | |
|---|---|
| Leja nr. | L. 1379/1 |
| Subjekti | "B&B Stone" sh.p.k |
| Minerali | Ranor Masiv |
| Lloji i lejes | Shfrytëzimi |
| Sipërfaqja, $km^2$ | 0.017 |
| Neritan Aleksi | data 24.06.2019 firma |

Kordinatat

| Pika | X | Y |
|---|---|---|
| 1 | 4507172 | 4420380 |
| 2 | 4507369 | 4420510 |
| 3 | 4507770 | 4420510 |
| 4 | 4507702 | 4420028 |
| 5 | 4507520 | 4420002 |
| 6 | 4507593 | 4420262 |
| 7 | 4507295 | 4420280 |
| 8 | 4507178 | 4420253 |

GREEN-STUDIO
Adresa:Lagja 7 Rr Hajdar Demiri Durres
Cel +355 69 37 67 595
E-mail:green-studio@hotmail.com
Green-Studio





Adresa:Lagja 7 Rr Hajdar Demiri Durres
Cel +355 69 37 67 595
E-mail:green-studio@hotmail.com
Green-Studio


PROFILI IV - IV ME PUNIMET
Shk 1: 1 000
460
450
440
430
420
410
400
+ 415
+ 420
Y = 44 20 300
Y = 44 20 400
Kufiri lejes
SHPJEGUES
Depozitime te Oligocenit te Siperm ranore silicore shtrese trashe te nderthurura me argjile
Punime te projektuara per vitin 2021 - 2022
Sterile
KORRIK 2021
OBJEKTI VODICE, ROSHNIK, BASHKIA BERAT
PROJEKT - PROGRAMI VJETOR 2021 - 2022
Administrator J. BOJAXHIU
Dr. Teknik A. PASHKU
Ing. Topograf I. KANANI
PROFILI VI - VI ME PUNIMET
POROSITES SHOQERIA " B & B STONE " sh.p.k
Shkalla 1 : 1000
Vizatimi 5




GREEN-STUDIO
Adresa:Lagja 7 Rr Hajdar Demiri Durres
Cel +355 69 37 67 595
E-mail:green-studio@hotmail.com
Green-Studio

***d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;***

***Pershkrimi i procesit ndertimor.***

Me projekt per tu mundesuar shfrytezimi i ranorit dekorativ, ne objektin Vodic Bogdan do te behet punime ndertimore si hapja e vendburimit vetem me rruge brenda karieres,pra nuk do te kete rruge per te shkuar ne objekt pasi rruga ekzistuese eshte ne afersi e cila eshte edhe fillimi i zones se shfrytezimit.

**Pershkrimi i procesit teknollogjike.**

Procesi teknollogjik i shfrytezimit te mineralit ranor masiv dekorativ ne kariere eshte i thjesht. Shfrytezimi do te behet nga larte poshte duke u ulur cdo 10m deri ne shkallen fundore .
Per realizimin e prodhimit, zbulimit, dhe kryerjen e proceseve te tjera pergatitore dhe ndihmese parashikohen makinerite e pajisjet si me poshte :

Prodhimi i blloqeve do te filloje mbasi te jete bere pastrimi i karrieres nga dherat dhe shkuret dhe te jene hapur transheja kapitale e hyrjes dhe ajo e prerjes.Menyra e vendosjes se blloqeve ne kete objekt mundesojne shfrytezimin ne disa blloqe dhe ne disa shkalle.Mund te punohet njekohesisht ne dy e tre blloqe ne menyre te pavarur.
Me mbritjen e transhese brendshme te hapjes ne horizontin krahas hapjes se transhese prerese ne nivelet e meposhtme mund te behet shfrytezimi nga lart poshte ne drejtim te horizonteve te meposhtme .Shfrytezimi do te kryhet mbasi te jete hequr mbulesa mbi blloqet.Pjerresia e renies se ketyre blloqeve eshte e bute 40-45°.Blloqet jane masiv me nje mbulese te vogel qe e keni llogaritur 5m te pa dobishme.
Shfrytezimi i blloqeve do te kryhet duke perdorur paisje te posaçme.
Ngarkimi blloqeve dhe sterilit do te kryhet me ekskavator dhe fadrome.Sasia e sterilit dhe mbules eshte ,1000m$^3$ /vit sasia e blloqeve 6000m3/vit .
Materiali mbulese e padobishme do te vendoset ne te gjithe brezat e sigurimit te lene ne çdo horizont.

Shkallet ne karriere do te jene me lartesi 10m.Shkalla me lartesi 10m do te ndahet ne dy nenshkalle me lartesi 5m.
Ndarja e shkalles ne dy nenshkalle me lartesi 5m behet me qellim qe te kryhen sa me pak prerje horizontale.Dimensionet e tjera do te jene ne funksion te kerkesave te tregut te brendshem dhe te eksportit.
Gjate shfrytezimit te ketij objekti do te perdoret metoda e ndarjes se blloqeve.Metoda qe do te perdoret per nxjerrjen e blloqeve do te jete:

- Prerja e siperfaqeve horizontale me fill te diamantuar.
- Prerja e siperfaqeve vertikale me bira me çekic mbi kallane.

Per zbatimin e metodes se pare do te kryhen dy shpime horizontale me kend 90°. Birat do te shpohen me sonde. Gjatesia e ketyre birave do te jene 10-15m. Mbas takimit te ketyre dy birave me ndihmen e nje grepi ose litari me presionin e ajrit kalohet nje litar i cili lidhet me fillin e diamantuar qe eshte vendosur ne makine. Makina e diamantuar duke kryer levizjen ne shina kryen edhe perqafimin e telit te diamantuar me bllokun qe do te presi. Per asnje çast filli i diamantuar te mos punoje ne te thate por gjithmone me uje te bollshem. FilIi i diamantuar do te presi siperfaqe $80m^2$ deri $150m^2$ njehereshi. Rendimenti i prerjes se makinave eshte 5-$6m^2$/ore. Per nje bllok gjithmon do te dalin dy faqe me prerje me tel te diamantuar.

Faqet e tjera te bllokut do te priten me bira.Ato do te kene largesi nga njera tjetra IS-2Scm mesatarisht 20cm. Per te prodhuar nje bllok me volum 1m" do te kryhen 2m2 prerje me tel te diamantuar dhe 4m2 prerje me bira. Per te kryer 4m2 prerje me bira do te duhen:Per nje faqe blloku me permasa 1m x 1m do te duhen te shpohen S bira
Sbira x lml= Sml. Per kater faqe do te duhen te shpohen 20 bira.
Duke marre parasysh koeficentin e rikuperimit prej 30% do te duhen per nje bllok 1m3 te kryhen prerje me fill te diamantuar 2m2 +2m2 x 10%=2.2m2
Prerje me bira marteli 20ml+20ml x 20%=24ml
Per kryerjen e prodhimit prej 10000m3 ne vit do te duhen: Prerje me fill te diamantuar 2.2m2/m3 x 10000m3/vit=22000m2/vit Prerje me bira 24m 11m3 x 10000m3/vit=240000ml/vit
Blloqet e vegjel qe kane ndarje natyrale do te nxirren direkt pa perdorimin e asnje metode.Kur blloqet do te jene te medhenj atehere do te perdoren metodat e pershkruara me poshte.

## Skica dhe Skema e Shfrytëzimit.






**dh) të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;**

*Lidhja me rrjetin elektrik*

Me rrjetin elektrik do të kemi lidhje në kabinën elektrike që do të vendoset në objekt nga OSHEE-ja e qytetit të Beratit.

*Furnizimi me ujë*

Furnizimi do të bëhet me mjetet e shoqerise. Uji që do të përdoret për nevojat e personelit qe punojne ne karriere. Brenda kordinatave te leej minerare është e vendosur depozita e ujit, nga ku bëhet shpërndarja me ndihmën e sistemit me rubineta.

*Ndikimet në ujrat sipërfaqësor.*

Zbatimi i ketij projekti nuk lë shkas për ndotjen e ujerave rrjedhëse sipërfaqesore nga ndotës të ndryshëm si karburantet, lëndët helmuese etj. Nuk pritet të ndodhë qoftë dhe ndonjë ndotje indirekte që mund të rezultoje nga shkarkimet në tokë, e me pas të shpelahen nga rreshjet, pasi ato nuk do të përdoren gjatë zbatimit të projektit apo rehabilitimit të territorit, ndërsa nga karburantet mund të ketë vetëm ndotje aksidentale nga rrjedhja e mjeteve të punës.

*Ndikimet në ujrat nëntokësor.*

Zbatimi i projektit mund të ndikoje disi në zgavrimim e metejshem të çarave të argjilës nga rritja e sasisë të ujerave sipërfaqësorë te rreshjeve për shkak të reduktimit të materialit të gjelbër që mbulon vende-vende territorin, duke rritur kështu kapacitetin e infiltrimit.

*Zhurmat*

Zhurma në këtë objekt do të shkaktohen vetëm nga procesi i shkeputjes se masivit te mineralit ranor dekorativ dhe nga mjetet e punes të cilat do të jenë shumë të vogla të cilat pothuajse nuk dëgjohen fare pasi ka nje distance te konsiderueshme nga qendrat e banuara.
Zhurmat e tjera do të jenë nga mjetet e ngarkimit dhe atyre të transportit. Zhurmë tjetër do të jete ajo e mjeteve të transportit , të cilat numri i tyre do të jetë shumë i vogël dhe zhurmat janë të papërfillshme dhe të kontrolluara.
Niveli i zhurmave të mjeteve të transportit është i atij niveli që nuk influencon fare si për të punësuarit dhe për banorët dhe gjallesat përreth tij.

**e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;**

Ndertimi ka perfunduar.

*Kohëzgjatja e planifikuar për funksjonimin e projektit*

Objekti do të funksionojë 10 vjet sic eshte e percaktuar ne lejen minerare.Gjatë kësaj periudhe do të ketë ndërhyrje të herëpasherëshme për mirëmbajtje dhe meremetim nga ana e shoqerise.

*Faza e planifikuar për reabilitimin e sipërfaqes pas mbarimit të projektit*

## PROJEKTI MBYLLJES DHE I REHABILITIMIT TE KARIERES DHE FAZAT E ZHVILLIMIT.

Mirembajtja e shesheve te shkalleve dhe hapja e rrugeve automobilistike dytesore midis shesheve te shkalleve.Me perfundimin e shfrytezimit te cdo shkalle ne çdo horizont do te lihet sheshi i sigurimit me gjeresi 4m.Me projekt eshte parashikuar qe keto sheshe te lidhen me rruge

automoblistike e cila do te sherbeje per te levizur lirshem punonjesit e komunitetit, kafshet shtepiake, kafshet e egra dhe per te kryer te gjitha punimet e nevojshme te rehabilitimit te zones se shfrytezuar mbjelljen e pemeve dhe gjelberimin e saj, si dhe mbushja me dhera humusore transporte te fidanave etj.

**Ndertimi kunetave ne pjesen e siperme te skarpates se shkalleve.**

Meqenese zona ku kryhet aktiviteti perbehet nga ranore te cilat ne periudha me rreshje humbin qendrushmerine, me projekt ne pjesen e siperme te skarpateve te shkalles se pare te shfrytezimit do te ndertohet kunete ne gjith gjatesine e skarpates. Ujerat e grumbulluar ne kunet do te mbroje skarpaten e shkalles dhe do ta percjelle ujin deri tek kolektori i grumbullimit te ujerave atmosferike.

**Hapja e kanaleve per dranazhim**

Ne fundin e skarpates se çdo sheshi shkalle do te hapen kanale me permasa 60 cmx50cm x 20cm dhe pjerresi 5 % nga te dy krahet e sheshit per kullimin e ujerave dhe rreshjeve atmosferike te cilat do te drenohen poshte kontureve te karieres, fenomen qe shmang grumbullimin e ujit ne sheshin e shkalles, mbron nga erozioni sheshin e sigurimit dhe te gjithe karrieren. Gjithashtu pjerresia e sheshit te siguris se shkalles duhet ti jepet pjerresi ne drejtim te kanalit.

**Mbulimi me dhera humusore i siperfaqeve te shesheve te shkalleve**

Duke qene se sheshet e shkalleve jane ne depozitime gelqerori ku bimesia nuk zhvillohet, per te krijuar kushte optimale per druret dhe bimesine qe do te mbillet e gjithe siperfaqja e shesheve te shkalleve do te mbushet me nje trashesi dheu vegjetal (Humusor) prej 0.3 m.

**-Masat rehabilituese**

Punimet qe do te kryen per rehabilitimin e zones se shfrytezuar

-Punime inxhinierike
-Punime biologjike

***-Punime inxhinierike***

-Hapja dhe mirembajtja e rrugeve automobilistike per hyrje ne sheshin e sigurise se shkalleve
-Hapja e kunetave dhe kanaleve per drenazhim dhe disiplinimin e ujerave te rreshjet atmosferike

***-Punime biologjike***

-Mbushja me dhera humusore me trashesi 30cm te shesheve te shkalleve dhe pergatitja e tokes per mbjellje me bimesi.
-Mbjellja e bimesise.
-Sherbimet profilaktike ne siperfaqet e rehabilituara.

## PLANI DHE MASAT PER REHABILITIMIN E MJEDISIT

Bazuar ne projektin e shfrytezimit hartuar per karrieren e ranor pllakor nje periudhe te 10 vjecare, per prodhimin 6000 m3/ vit.Per rehabilitimin e kesaj siperfaqeje, i cili do te filloje ne vitin e trete te shfrytezimit te mineralit Subjekti ne zbatim te legjislacionit Shqiptar do te paguaj garancine bankare te rehabilitimit dhe ne vartesi te kushteve ose do ta rehabilitoje vet zonen e shfrytezuar ose do ja delegoje ndonje subjekti te specializuar.

**Punimet e rehabilitimit konsistojne si me posht**.

-Krijimin e siperfaqeve per mbjellje
-Sistemimin e materialit te mbuleses te depozituar paraprakisht ne kufijte e karrieres.
-Mbjelljen e siperfaqeve te reja me shkurre te egra dhe drure si dellinja ,mare dhe pralle dhe barishte te ndryshme.
-Mirembajtjen e siperfaqeve te mbjella.

**Masat zbutese te ndikimeve negative gjate procesit te shfrytezimit.**

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne uljen e ndotjeve gjate punimeve ne kariere te ajerit nga pluhuri, gazet mbrojtja nga zhurma,si dhe uljen e efekteve negative hapsinore dhe ne territor, ne faunen dhe floren.Por pikesynimi kryesor i studimit mbetet rehabilitimi i tokes dhe evitimi ne maxiimum i erozionit.

**Masat konkrete qe do te merren gjate punimeve do te jene** :

-Mbjellje me filiza, ulliri, mare, dushku, pishe e gjithe periferise me te larte te shpatit te territorit gjate shfrytezimit. Kjo mase do te sherbeje edhe per uljen e nivelit te pluhurave dhe zhurmave ne vazhdim te projektit, si dhe te rrise mundesimin per vetegjenerim te drureve ne pjesen e larte me shpatin tjeter te kodres.
-Pemiresimin e bimesise ne te gjitha periferine e karieres me bimesi te zones si dellenje te kuqe dhe shkoze te bardhe, per te izoluar pjesen e fragmentizuar nga shfrytezimi prej atyre te paprekura nga projekti duke lene mundesine per perhapje te metejshme te ketyre specieve vendase ne territoret fqinje.Te dy keto masa mund te sherbejne si bariera per pluhurin qe mund te nxirret nga aktiviteti eolik gjate shfrytezimit.
-Uljen e prodhimit per stinen e veres duke evituar keshtu me sa te jete e mundur pluhurat. Nga ana tjeter per te ulur efektet negative, gjate periudhave te thata do te perdoret lagia e shesheve te punes dhe sidomos,lagia e materialit te nxjere. Kjo do te mbroje ambjentin nga pluhuri gjate transportit te prodhimit

**Rehabilitimi i territorit**

Masat rehabilituese do tekonsistojne ne :
-Uljen e erzionit
-Restaurimin e habitateve
-Pasurimin e biodiversitetit me speciet natyrore.
-Rritjen e vlerave vizuale dhe rikrijuese te territorit qe do te shfrytezohet.

Se pari shfrytezimi me tarace me lartesi 10 m, eshte bere per te lehtesuar zbatimin e planit te rehabilitimit. Keto taraca do te lejojne si mbulimin e siperfaqes me gjelberim ashtu edhe evitimin e pamjeve te pakendeshme te shpateve vertikale te tarracave qe mund te mbeten zbuluar ne rastet e lartesise se pergjithshme te tarraces rreth 10 m.

Rradha e mbjelljeve do te jete nga lart-poshte, duke lejuar mundesine per veteperhapjen e specieve mbi bazat e aktivitetit eolitik dhe forces se rendeses. Gjeresia e shkalles se taraces do te jete 4m. Kjo lloj mbjellje lejon veteperhapjen e species, si dhe nuk demton ne rritjen e bimeve pasi nuk pengon dritezimin.

**Rehabilitimi i tokes**

Per rehabilitimin e tokes, do te shfrytezohen mbetjet e imeta nga materiali i nxjerre dhe do te plotesohet me 10 cm dhera humusore te pasur me pleh.Nese do te nevojitet stabilizimi i ketij dheu nje pjese e faqes se pjerret do te behet me trungje te ngulura me thellesi 30 cm, mulcirimi do te jete i thate dhe me kashte, gjethe te bimeve te zones dhe dege. Mulcirimi do te sherbeje si per uljen e humbjeve te farnave nga largimi prej aktivitetit eolik, ashtu dhe per uljen e aktivitetit erodik per sa kohe vegjitacioni eshte i pa zhvilluar mire.Mbjelljet do te kene renditjen me largesi fidanesh cdo 10 m, gje qe do ti jape nje kurore dendesi mjaft e mire territorit pas shfrytezimit, dhe lejon dritezimin per veterritjen dhe zhvillimin e bimeve natyrore.

**REHABILITIMI I PLOTE I MJEDISEVE TE TERRITORIT DO TE JETE SI ME POSHTE:**

**Mbjellja e taracave**

-Mbjellje e fushes se shfrytezuar
-Mbjellje e taracave ne shkallet e karieres
-Filiza 2 vjecare ne periferi
-Mbjellje e filizave 2 vjecare te pemeve dhe lejimi i perteritjes se shkurreve.

Nga vete rehabilitimi i habitateve me perparsi do te marre rritja e abudances se shpendeve dhe zvarranikeve dhe njekohesisht do te shtohen si habitatet ashtu dhe rezervat natyrore edhe per gjitaret e larte si lepuri etj. prej ketej do te rritet edhe mundesia e pranise se mishngrenesve te larte si qelbesit dhe buklit (nuses se lales )

**LLOGARITJA E SHPENZIMEVE TE REHABILITIMIT**
**Projekti i i rehabilitimit,Gjendja ne fund te shfrytezimit**
Siç eshte theksuar edhe me siper shfrytezimi i ketij objekti do te behet me kariere.
Siperfaqja qe shoqeria "***B&B STONE***" shpk ka fituar konkurimin eshte **0.017km2** dhe me nje prodhim 6000m3 m3/vit.

**Shuma e pergjitheshme per mbylljn edhe rehabilitimin e karieres do te jete 2753058 lek**

**ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit**

Karriera eshte egzistuese.

**f) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);**

Karriera eshte egzistuese

**g) informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;**

Ky objekt nuk është i lidhur me objekte të tjera të zonës ku do zhvillohet si aktivitet.

**gj) informacion për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;**

Aktiviteti disponon leje minerare per shfrytezim te mineralit ranor masiv,me vendodhje në, Vendburimi Vodice-Bogdan,Roshnik,Berat. Leja e shfrytezimit me nr 1379/1 ka nje siperfaqe prej 0.017 km2.

**h) të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe për mënyrën e sigurimit të tyre;**

Lend te para nuk perdoren pasi lenda plasese shkaterron masivin.Përsa i përket lëndës djegëse që nevojitet për mjetet e punës ajo do të merret në karburantin më të afërt.

**i) të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;**

Për funksionimin e aktivitetit nuk nevojiten ngritja e ngrehinave për strehimin e fuqisë punëtore për arsye të distancës së afërt të zonës së shfrytezimit me fshatin ku ndodhet fuqia puntore.

**j) informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit**

Disponojme leje minerare nr 1379/1.
Jemi ne fazen e njoftimit per Vnm te Thelluar per funksionimin e aktivitetit.

**k) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.**

Leje Minerare nr 1379/1.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**LEJE**

PN-9645-12-2019

NUIS/NIPT: K73627001A

B&B STONE

Adresa Berat BERAT Berat Adresa: Lagjja " Barrikada ", rruga " Ismail Klosi ", godina nr.10, ish - Uzina Mekanike, zona kadastrale nr.8501, me numer pasurie

Kodi IV.1.B.2

Kodi tjetër

Data e lëshimit 2009-07-03

Afati i vlefshmërisë Jul 3 2029

Kategoria

Minerare ose hidrokarbure

Nënkategoria

Leje Shfrytëzimi

Veprimtari specifike

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Shfrytëzimi i mineralit Ranor Masiv

Kufizime specifike

Leja ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Leja ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Qarku: Berat Rrethi: BERAT B/K: Roshnik Q/F: Adresa: Vendburimi "Vodicë Bogdani - Roshnik"

Nënshkrimi i sportelit ____________________

Vulosur elektronikisht nga Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2020/11/11 13:58:46 +02'00'
K73627001A20201111135727854006

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)*

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 19793 prot.
Datë 27.11.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**
**MINISTRI**

Nr. 6101/2 prot. Tiranë, më 25.11.2019

Lënda: Akt – Miratimi mbi kërkesën me numër çështje, LC – 4186 – 12 – 2018.

**QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT**
Blv: " Zhan D`Ark", Prane Ministrisë së Jashtme,Tiranë.

**AGJENCISË KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE**

" Blloku Vasil Shanto", NR.18, Tiranë.

**SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR**
Rruga: " Myslym Keta", Tiranë.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Akt – Miratimin Nr.1379/1, për shtyrje afati të Leje Minerare të Shfrytëzimit Nr.1379, dt 03.07.2009 ,(*leje e mëparëshme*) për mineralin ranor masiv, të subjektit **" B&B STONE "Sh.p.k,** për kerkesën në QKB me numër çështje **LC – 4186– 12– 2018, dt 18.12.2018,** në objektin " Vodicë Bogdani ", Roshnik, Qarku Berat.

Ky Akt - Miratimi shoqerohet me aktin e verifikimit te AKBN, për lejen minerare Nr.1379, dt 03.07.2009, për vleresimin për kushtet e lejimit të AKBN, oponencën e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytezimit dhe Vendimin e Keshillit Teknik të AKBN, Nr.745, dt 18.04.2019, "*Për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit me numër aplikimi në QKB nr.LC– 4186 –12-2018, datë 18.12.2018, të subjektit " B & B STONE" Sh.p.k, për shtyrje afati të Lejes Minerare të Shfrytezimit Nr.1379, datë 03/07/2009, në objektin e mineralit, ranor pllakor "Vodicë – Bogdani" Roshnik, Qarku Berat,* ardhur me (Nr.6101, prot MIE, datë 19/06/2019 dhe nr.1455/3, prot AKBN dt 19.06.2019).

Faleminderit për bashkëpunimin.

**MINISTRI**

**Belinda Balluku**

**Me Autorizim**

**ZËVENDËSMINISTRI**

**Ilir Bejtja**

Adresa: Rruga " Abdi Toptani",Nr.1, Tiranë, Faqja web: http:/www.infrastruktura.gov.al

GREEN-STUDIO
Adresa:Lagja 7 Rr Hajdar Demiri Durres
Cel +355 69 37 67 595
E-mail:green-studio@hotmail.com
Green-Studio

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**
**MINISTRI**

Nr. 6101/1 Prot. Tiranë, më 25/1/2019

## AKT – MIRATIMI NR. 1379/1

Për Aplikimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për Leje Minerare Shfrytëzimi, me numër çështje **LC –4186 – 12 - 2018 dt 18.12.2018,** dorëzuar nga ana e subjektit **" B & B STONE" Sh.p.k,** për shtyrje afati të Lejes Minerare të Shfrytezimit **nr.1379 datë 03/07/2009,** zotëruar nga ana e subjektit **" B& B STONE " Sh.p.k** (leje e mepareshme) **për mineralin ranor masiv,** që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore, për objektin **"Vodicë Bogdani ", Roshnik, Qarku Berat.**

1.Të dhëna për përfituesin e lejes minerare të shfrytëzimit:

a) Emri i subjektit: **" B&B STONE" Sh.p.k ;**
b) Emri dhe mbiemri i përfituesit të lejes: **znj. Julia Bojaxhiu**
c) Lloji i mineralit për të cilin miratohet leja: Ranor Masiv.
d) Adresa e selisë se subjektit: Lagjia " Barrikada", Rruga " Ismail Klosi", Godina nr.10, ish, ish – Uzina Mekanike, zona kadastrale nr.8501, me numër pasurie 19/123, Berat.
e) Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor: **znj. Julia Bojaxhiu**
Nr.telefonit /faksit: **Cel; +355 69 839 4530**
f) Emërtimi i njësisë vendore ku do të kryhet aktiviteti:**Njësia Administrative Roshnik, Bashkia Berat, Qarku Berat.**
e) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik; Hektor Dhamo,ing.miniere, pajisur me leje profesionale, nr.309, dt 05/04/2013.
f) Data e përfundimit të licencës profesionale të drejtuesit teknik: **pa afat.**

2. Kjo leje jepet në përputhje me nenin 24, dhe kreun e IV të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij dhe i siguron të drejtën ekskluzive subjektit përfitues të shfrytëzojë llojet e mineralit/mineraleve, të përcaktuara në leje, por brenda zonës së lejuar të shfrytëzimit, për një periudhë vlefshmërie prej 10 vjet *me mundësi të zgjatjes vetëm një herë të afatit për 10 (dhjetë) vjet, me kërkesë të zotëruesit të lejes së paku 180 (njëqindetetëdhjetë) ditë kalendarike para mbarimit të afatit fillestar të vlefshmërisë.*) nga data efektive e dhënies se lejes për shfrytëzim.

3.Kjo leje jepet për veprimtarinë minerare të shfrytëzimit të mineralit;

**Ranor masiv,** që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore.

4.Koordinatat në plan të zonës së lejuar minerare për zhvillimin e veprimtarisë së shfrytëzimit janë;

## Leja Minerare Nr.1379/1




**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE DHE INDUSTRISË
OBJEKTI "Vodice Bogdani", Roshnik, Qarku Berat

| | |
|---|---|
| Leja nr. | L. 1379/1 |
| Subjekti | "B&B Stone" sh.p.k |
| Minerali | Ranor Masiv |
| Lloji i lejes | Shfrytëzimi |
| Sipërfaqja, $km^2$ | 0.017 |

Neritan Aleksi — data 24.06.2019 — firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË – SEKRETARIA

| Kordinatat | | |
|---|---|---|
| Pika | X | Y |
| 1 | 4507172 | 4420380 |
| 2 | 4507369 | 4420510 |
| 3 | 4507770 | 4420510 |
| 4 | 4507702 | 4420028 |
| 5 | 4507520 | 4420002 |
| 6 | 4507593 | 4420262 |
| 7 | 4507295 | 4420280 |
| 8 | 4507178 | 4420253 |

| PIKA | KOORDINATAT X | Y |
|---|---|---|
| 1 | 45 07 172 | 44 20 380 |
| 2 | 45 07 369 | 44 20 510 |
| 3 | 45 07 770 | 44 20 510 |
| 4 | 45 07 702 | 44 20 028 |
| 5 | 45 07 520 | 44 20 002 |
| 6 | 45 07 593 | 44 20 262 |
| 7 | 45 07 295 | 44 20 280 |
| 8 | 45 07 178 | 44 20 253 |

Sipërfaqja e zonës së lejuar minerare është **0.017km²** *(një e tëre jo me vogel se vlera e përcaktuar e përcaktuar në tabelën e miratuar me vlerat minimale të sipërfaqeve të lejeve minerare sipas programit të veprimit, dhe jo më e madhe se 5(pesë)km²).*Zona e lejuar minerare për realizimin e veprimtarisë së shfrytëzimit është përshkruar në hartën që bashkëngjitet këtij akt - miratimi, firmoset nga Ministri ka vulën e MIE dhe është pjesë e tij.

5.Përfituesi i lejes minerare të shfrytëzimit është i detyruar të respektojë kërkesat e ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; si dhe kërkesat e legjislacionit mjedisor apo legjislacioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë që lidhen me operacionet e punës së tij gjatë veprimtarisë minerare të shfrytëzimit të mineraleve për të cilët i është dhënë kjo leje. Në mënyrë të specifikuar kërkohet respektimi i afateve ligjore për rastet kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar ose ta pezullojë përkohësisht veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar.

6.Përfituesi i lejes minerare brenda afatit të miratuar të lejes minerare të shfrytëzimit duhet të realizojë programin e investimit vjetor dhe atë të investimit total sipas përcaktimeve të tabelës se mëposhtme:

| **Periudhat e punës sipas viteve të punës.** | **Aktivitet** | **Shpenzimet për programin e investimit ne ( lekë)** |
|---|---|---|
| Periudha, Viti i parë, max | Investime pjesë ndërrimi për makineri e pajisje teknologjike, infrastrukturë në rrugë. | **650 000 lekë** |
| **Totali** | | **1 150 000 lekë** |

7. Veprimtaria minerare e shfrytëzimit gjate periudhës së shtesës se afatit të lejes në programin e investimit sipas projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit do të përmbajë këto operacione pune; hapje rruge për nivelet e sipërme të karierës, pajisje e makineri me nje vlerë totale prej 1 150 000 lekë.

Veprimtaria minerare e shfrytezimit do te realizohet per shfrytezimin e mineralit;

| | | |
|---|---|---|
| **a) Prodhim minerali ne total** | **52 500** | $m^3$ |
| **c) Prodhim minerali ne vit** | **6 000** | $m^3$/vit |
| **d) Rezerva gjeologjike** | **392 600** | $m^3$ |
| **e) Rezerva te nxjerrshme,** | **298 350** | $m^3$ |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ... INFRASTRUKTURËS ... SEKRETARIA

Adresa: Rruga " Abdi Toptani", Nr.1,Tiranë, Faqja web: http:/www.infrastruktura.gov.al

c) Fuqia punetore për realizimin e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të shfrytezimit gjate periudhës së shtesës së afatit të lejes minerare do të **10( dhjetë) punonjës.**

e) **Afati shtesë i lejes minerare të shfrytezimit është 10 ( dhjetë ) vjet.**

8. Vlera totale financiare për realizimin e programit të investimit gjatë periudhës së shtesës së afatit të lejes minerare, e miratuar me VKT të AKBN, Nr.745 datë 18.04.2019, me (Nr.6101 prot MIE datë 19/06/2019 dhe nr.1455/3, prot AKBN dt 19.06.2019) është **1 150 000 lekë.**

8/1. Vlera vjetore financiare për realizimin e programit të investimit gjate periudhës së vitit të parë të shtesës se afatit te lejes minerare (viti me investime me te larta), e miratuar me VKT të AKBN, Nr.745 datë 18.04.2019, me (Nr.6101 prot MIE datë 19/06/2019 dhe nr.1455/3, prot AKBN dt 19.06.2019) është **650 000 lekë.**

8/2. Vlera e garancisë financiare për realizimin e programit të investimit gjatë periudhës së vitit te parë të shtesës së afatit të lejes minerare (si viti me investime më të larta) e miratuar me VKT të AKBN, Nr.745 datë 18.04.2019, me (Nr.6101 prot MIE datë 19/06/2019 dhe nr.1455/3, prot AKBN dt 19.06.2019) është **65 000 lekë.**

9. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit për 10 vitet e mbetura per periudhën shtese te afatit te lejes minerare do te jetë; si më poshtë vijon;
Vlera totale për 8.53 ha do të jetë 2 753 058 lekë.
Paguar për periudhën 2011 – 2019 = 2 395 520 lekë.
Vlera e mbetur e garancisë së rehabilitimit për 10 vitet e ardhshme = **357 538 lekë.**

10. **Vlera vjetore e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, gjatë periudhës 10 vjecare të shtesës së afatit të lejes minerare** e miratuar me VKT të AKBN, Nr.745 datë 18.04.2019, me (Nr.6101 prot MIE datë 19/06/2019 dhe nr.1455/3, prot AKBN dt 19.06.2019) është **35 754 lekë.**

11. Veprimtaria minerare e shfrytëzimit në zonën e lejuar minerare të shfrytëzimit duhet të respektojë këto kondita specifike:
   - ***Në pjesën Veri Perendimore të zonës ndodhen objekte banimi. Në Plan Vendosjen bashkëlidhur akt – Verifikimit te VKT të AKBN, është përcaktuar zona në të cilën nuk duhet të punohet me lëndë plasëse për mbrojtjen e tyre. Në pjesën Veriore ndodhen dhe sipërfaqe të mbjella me ullinj.***

*a)Te njohë e te zbatojë rregulloren e teknikes se sigurimit per minierat dhe karrierat.*
*b)Te vleresoje rehabilitimin progresiv dhe perfundimtar te mjedisit dhe te mos shkaktoje demtime te tij.*
*c)Te kontrolloje vazhdimisht dhe te mirmbaje ne gjendjen teknike sheshet e sigurise ne shkalle dhe ti kushtohet vemendje ruajtjes se kendit te projektuar per pjerresine e shpateve te shkalleve, si dhe rritjen e vemendjes ne ndarjen e shkalles në nën shkalle per nje efektivitet e kontroll me te mire te proçesit te nxjerrjes.*
*d)Per kushtet gjeografike specifike ne te cilen ndodhet objekti, subjekti duhet te vleresoje sigurimin e mjeteve mbrojtese individuale per punonjesit, sigurimin e paketes mjekesore te domosdoshme per ndihmen e pare ne raste nevoje si dhe gjate gjithe kohes duhet te mbaje ne gadishmeri makine transporti ne gjendje pune.*

12.Data efektive e lejes minerare të shfrytëzimit është data e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

13.Përfituesi i kësaj leje duhet të respektojë përmbushjen në afat dhe me korrektësi për



GREEN-STUDIO
Adresa:Lagja 7 Rr Hajdar Demiri Durres
Cel +355 69 37 67 595
E-mail:green-studio@hotmail.com
Green-Studio

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**
**AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE**
**DREJTORIA MINERARE**

**Nr.** 2203/2 **Prot.** **Tiranë, më** 01/11/**2021**

**Lënda:** **MIRATIMI I PROGRAMIT VJETOR TË PUNËS PËR PERIUDHËN 03.07.2021 deri 03.07.2022**

**"B & B STONE" sh.p.k**
**Z. Julia BOJAXHIU**
Lagjja "Barrikada", Rruga "Ismail Klosi", Godina Nr. 10, ish - Uzina Mekanike, Zona Kadastrale nr. 8501, me nr.pasurie 19/123, Berat.

Grupi i punës i ngritur me Urdhërin nr.8 datë 16.01.2018, të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-s "***Për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit të planit vjetor të punës nga zotëruesit e lejeve minerare", i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr.10304, datë 15/07/2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe të VKM nr. 232, datë 23/03/2011 "Për Miratimin e Funksioneve të Strukturave Përgjegjëse në Sektorin Minerar të Republikës së Shqipërisë",*** pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga ana Juaj, vendosi:

**Miratimin e Programit Vjetor të Punës, për Lejen Minerare Nr. 1379/1 datë 03.07.2009,** Objekti: "Vodicë Bogdani", Roshnik, Bashkia Berat për shfrytëzimin e mineralit Ranor Silicor, për periudhën 03.07.2021 deri më 03.07.2022.

Ju bëjmë me dije, se zbatimi i programit vjetor të punës për periudhën 03.07.2021 deri më 03.07.2022, nga ana e shoqërisë Tuaj, do të jetë objekt i kontrollit të vazhdueshëm nga strukturat tona të specializuara.

Në zbatim të nenit 18 pika 1/ç, 25/ç dhe 27 pika 2/c të ligjit nr.10304, datë 15/07/2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", subjekti i liçencuar ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin për raportimin e aktivitetit të kryer gjatë periudhës 03.07.2021 deri më 03.07.2022, për shqyrtim në AKBN jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi e lejes minerare, pra në datën 03.06.2022.

Në rast të mosrespektimit të këtij afati në zbatim të nenit 45, pika 1, shkronja dh, e ligjit nr.10304, datë 15/07/2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", shoqëria Juaj do të gjobitet me një shumë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
Mosrespektimi i këtij afati për herë të dytë, dënohet me dyfishin e gjobës së parashikuar dhe mund të shoqërohet me pezullimin e lejes minerare deri në plotësimin e detyrimit ligjor.

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!*

**DREJTORI EKZEKUTIV**

**ADRIAN BYLYKU**

*Adresa: Bulevardi " Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri. Web: www.akbn.gov.al*
*Tel. +355 (0) 4 225 7117; Fax +355 (0) 4 225 7382*

detyrat e lëna nga strukturat përgjegjëse mbikëqyrëse e monitoruese të përcaktuara sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

14. Çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i dhënë në lidhje me këtë leje ka vlerë legale nëse është dorëzuar me shkrim dhe është dërguar me postë ose me fax. pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ose :

MINISTRIT zonjës ____________________

i. me postë: ADRESA Rruga " Abdi Toptani" Nr.1, Tiranë, Shqipëri
ii. me fax.: Nr.....................................................

ZOTËRUESI I LEJES SHFRYTËZIMIT

ZOTËRUESIT TË LEJES SHFRYTËZIMIT **znj.Juliana Bojaxhi**

Shoqërisë: " **B & B STONE " Sh.p.k** ;
me postë : Lagjia " Barrikada", Rruga " Ismail Klosi", Godina nr.10, ish, ish – Uzina Mekanike, zona kadastrale nr.8501, me numër pasurie 19/123, Berat.

ii. me fax; **Cel; +355 69 839 4530**

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

* Shënim:

